



Shëndeti

Sistemi shëndetësor
Sigurimi nga sëmundjet dhe aksidentet
Shërbimet mjekësore
Shtatzënia / lindja
Shëndeti psikik
Rasti i vdekjes

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor në Zvicër është ndërtuar shumë mirë. Në mënyrë të gjithëpërfshirëse, të gjitha banoret dhe banorët janë detyrimisht të siguruar nga aksidentet dhe sëmundjet. Një numër i madh ordinancash mjekësore, barnatoresh dhe spitalesh e sigurojnë shërbimin.

Sistemi i sigurimit

Në Zvicër, të gjitha banoret dhe banorët duhet të kenë një sigurim nga aksidentet dhe sëmundjet. Kush shpërngulet këtu, duhet t'i lidhë kontratat e sigurimeve në tre muajt e parë. Fëmijët duhet të sigurohen brenda tre muajve pas lindjes. Shërbimet e sigurimeve të detyrueshme janë të rregulluara me ligj. Të gjithë të siguruarit kanë të drejtë për të njëjtin trajtim mjekësor.

Financimi

Sistemi shëndetësor zviceran financohet së bashku prej shtetit (konfederata, kantonet, komunitet, punëdhënësve dhe personave privatë. Personat privatë paguajnë një shumë mujore sigurimi për sigurimin e përkujdesjes gjatë sëmundjes dhe për sigurimin e aksidenteve. Shuma vendoset çdo vit dhe ndryshon sipas kantonit. Kush sëmuret apo ka një aksident, duhet të marrë gjithashtu pjesë në shpenzimet (shuma e përcaktuar dhe pjesëmarrja sipas përqindjes, Franchise und Selbstbehalt). Mirëpo këtu ka një shumë të përcaktuar maksimale në vit.

Përkthimet

Nuk është e lehtë, kur duhet të komunikoni në një gjuhë të huaj me mjeket, farmacistët apo infermierët. Prandaj disa spitale ofrojnë përkthime falas përmes interpretuesve ndërkulturorë të shkolluar posaçërisht. Pacientet dhe pacientët duhet të informohen vetë me kohë për këtë mundësi. Sado, interpretuesit mund të angazhohen gjithashtu për vizita mjekësore ose situata të tjera. Mirëpo atëherë duhet të paguhet vetë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/sistemi-shendetesor

Sigurimi nga sëmundjet dhe aksidentet

Kush banon në Zvicër, duhet të ketë një sigurim nga aksidentet dhe një sigurim nga sëmundjet. Këto sigurime private i heqin shpenzimet në rast aksidenti, sëmundje apo shtatzënie. Për të dy sigurimet duhet të lidhet kontrata brenda tre muajve të parë pas ardhjes në Zvicër.

Sigurimi shëndetësor me përkujdesje (sigurimi bazë)

Të gjitha banoret dhe banorët në Zvicër duhet të lidhin vetë me patjetër një sigurim shëndetësor (sigurim bazë, Grundversicherung). Kush vendoset në Zvicër, ka tre muaj kohë për ta bërë. Nëse dikush sëmuret në këtë kohë, shpenzimet e shkaktuara merren përsipër edhe me prapaveprim. Sigurimi bazë ofrohet prej shumë kompanive private të sigurimeve shëndetësore (Krankenkassen). Zgjedhja e një kompanie sigurimesh shëndetësore është e lirë. Kompanitë e sigurimeve shëndetësore duhet t'i marrin të gjithë personat, që jetojnë në Zvicër.

Të siguruarit paguajnë një një prim mujor. Në varësi të kompanisë së sigurimeve shëndetësore dhe të modelit të sigurimit, këto prime kanë lartësi të ndryshme; prandaj ia vlen të krahasohen ofertat. Ju mund ta ndërroni kompaninë e sigurimeve shëndetësore deri në fund të nëntorit për vitin e ardhshëm. Sigurimi bazë nuk i heq vetëm shpenzimet, kur dikush sëmuret, ai paguan edhe në shtatzëni dhe në lindje. Shërbimet janë të rregulluara me ligj.

Kujdes: Shpenzimet për mjekimin e dhëmbëve apo syzet normalisht duhet të paguhen vetë ose nëpërmjet një sigurimi suplementar vullnetar.

Sigurimi nga aksidentet

Të punësuarit janë të siguruar automatikisht përmes punëdhënësit nga aksidentet gjatë punës dhe në kohën e lirë, nëse punojnë më shumë se 8 orë në javë. Kush punon më pak, nuk është siguruar nga aksidentet në kohën e lirë dhe duhet të kujdeset vetë për një sigurim nga aksidentet. Kjo vlen edhe për të vetëpunësuarit dhe të gjithë personat, që nuk janë në marrëdhënie pune. Personat, që nuk janë në marrëdhënie pune, duhet të lidhin një kontratë sigurimi nga aksidentet pranë kompanisë së tyre të sigurimit shëndetësor. Të vetëpunësuarit mund të lidhin një kontratë sigurimi nga aksidentet edhe te kompani të tjera sigurimesh. Të siguruarit duhet të paguajnë prime mujore. Te të punësuarit, këto prime zbritet direkt nga paga.

Lirimi i primeve

Kush nuk është në gjendje financiare t'i paguajë primet e sigurimit shëndetësor, ka sipas rrethanave të drejtën për lirimin e primit (Prämienverbilligung) për sigurimin bazë. Për të marrë lirimin, personi duhet të parashtrojë një formular kërkesë dhe të bëjë deklaratë rreth pasurisë dhe të ardhurave. Kur kërkesa pranohet, aplikuesi paguan prime më të ulëta duke filluar nga muaji i ardhshëm. Enti për kontribute sociale (Amt für Sozialbeiträge) informon për lirimin e primit dhe e merr kërkesën.

Sigurime plotësuese për sigurimin bazë

Si shtesë për sigurimin e detyruar bazë mund të lidhen kontrata për sigurime të ndryshme plotësuese (Zusatzversicherungen). Këto i mbulojnë shërbimet, të cilat nuk paguhen nga sigurimi bazë, p.sh, mjekime dhëmbësh. Sigurimet plotësuese ofrohen po thuajse prej të gjitha kompanive të sigurimeve shëndetësore. Kompanitë e sigurimeve shëndetësore mund të vendosin vetë, a dëshirojnë të sigurojnë dikë apo jo, dhe ato mund të paraqesin kushte.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/sigurimi-per-semundje-dhe-aksident

Shërbimet mjekësore

Kush sëmuret apo ka një aksident, duhet të shkojë në të shumtën e rasteve së pari te një mjek familjare ose te një mjek familjar. Te sëmundjet e lehta apo aksidentet, ndihma mund të merret edhe në barnatore. Vetëm te aksidentet vërtet të rënda duhet të shkohet direkt në spital.

Barnatoret

Barnatoret shesin barna, për të cilat duhet detyrimisht një recetë (e lëshuar nga mjeku), si dhe të gjitha barnat e tjera. Për një sëmundje të lehtë rekomandohet, që të shkoni fillimisht në barnatore. Farmacistet dhe farmacistët janë të arsimuar mirë dhe këshillojnë klientet dhe klientët e tyre. Barnatorja për raste urgjente në adresën Petersgraben 3 është e hapur edhe natën dhe në fundjavë, kështu që edhe në raste urgjente mund të merren barna.

Mjekja familjare / mjeku i fëmijëve

Në Zvicër, shumë persona kanë një mjek familjar ose një mjek familjare (Hausarzt oder Hausärztin). Këta e njohin ecurinë personale të të sëmurit dhe është personi i parë kontaktues në problemet mjekësore. Për fëmijët ka pediatër dhe pediatre. Nëse është e nevojshme, ata i drejtojnë pacientët te mjekët specialist apo në spital. Vetëm në raste të rënda emergjente duhet shkuar direkt në spital. Për të gjitha emergjencat e tjera jashtë orarit të punës të ordinancave përgjigjet qendra e thirrjeve urgjente mjekësore (Medizinische Notrufzentrale, MNZ). Ajo është mund të kontaktohet 24 orë në ditë në numrin 061 261 15 15. Për urgjenca me fëmijë dhe adoleshentë jashtë orareve të ordinancave pediatrike mund të telefonohet Medgate Kids Line me numrin e telefonit 0900 11 44 11, telefonatë e cila kushton.

Dentisti

Mjekimet e dhëmbëve normalisht duhet të paguhen vetë. Mirëpo ekziston mundësia të lidhet kontratë për një sigurim shtesë, që i mbulon trajtimet e dhëmbëve. Fëmijët, që shkojnë në shkollë, kanë të drejtën për një kontroll të dhëmbëve në vit. Informacione për këtë jep shkolla.

Spitali / Repartet e rasteve emergjente

Kur dikush duhet të shtrihet në spital (Spital), ai lajmërohet atje në shumicën e rasteve nga një mjek apo mjek. Përrjashtim bëjnë aksidentet e rënda, ku është nevoja të shkohet direkt në repartin e rasteve emergjente. Nëse situata është kërcënuese për jetën apo nëse pacienti ka nevojë për transport, duhet të telefonohet numri emergjent 144. Mjekja apo mjeku familjar merr përsipër rastet më pak të rënda.

Përkujdesja në shtëpi

Të sëmurit apo nevojtarët për përkujdesje, të cilëve iu duhet mbështetje në shtëpi, mund të marrin shërbimet e përkujdesjes ndaj të sëmurëve jashtë spitalit (Spitex). Personeli i kualifikuar viziton pacientet dhe pacientët në shtëpi për të përkujdesur për ta apo për t'iu ndihmuar në punët e shtëpisë. Kjo ofertë iu drejtohet personave, që kanë nevojë për mbështetje për shkak të sëmundjes, aksidentit, ankesat e pleqërisë, komplikimet në shtatzënësi apo pas lindjes. Shpenzimet mbulohen pjesërisht nga sigurimi bazë (Grundversicherung). Përveç Spitex Basel ka një numër të madh ofruesish privatë për Spitex.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/sherbimit-mjekesore

Shtatzënia / lindja

Gratë shtatzëna nuk duhet t`i paguajnë vet kontrollet e nevojshme. Edhe shpenzimet e lindjes i merr përsipër sigurimi bazë. Para dhe pas lindjes, prindërit mund të këshillohen falas.

Shërbimet gjatë shtatzënisë dhe lindjes

Shërbimet mjekësore në lidhje me shtatzëninë ose lindjen mbulohen nga sigurimi shëndetësor bazë (Grundversicherung). Këtu bëjnë pjesë kontrollet e rregullta para lindjes, lindja vetë dhe përkujdesja e nevojshme më pas. Gratë shtatzëna duhet t`i drejtohen me kohë një mjekë, mjeku apo mamie. Spitalet dhe mamitë ofrojnë kurse përgatitjeje për lindjen (Geburtsvorbereitungskurse). Ka kurse speciale për migrante dhe migrantë. Lindja mund të bëhet në spital, në një shtëpi lindjeje apo te shtëpia.

Pas lindjes

Është e zakonshme në Zvicër, që prindërit të këshillohen pas lindjes. Për këtë ekziston këshillimorja për prindërit (Elternberatungsstelle). Kjo jep informacione për zhvillimin, ushqimin dhe përkujdesjen e foshnjës. Këshillimet janë falas. Mjeku, mjekja apo mamia informojnë për kontrollet e mëpasshme, që janë të nevojshme për nënën dhe foshnjën. Është shumë e rëndësishme, që fëmija më së voni tre muaj pas lindjes të sigurohet kundër sëmundjeve dhe aksidentit (sigurimi bazë, sigurimi për aksident). Më së miri është kjo të bëhet tashme para lindjes.

Vaksinime

Rekomandohet, që fëmijët të vaksinohen me kohë kundër disa sëmundjeve. Sado, vaksinimet nuk janë të detyrueshme. Shpenzimet për vaksinimet e rekomanduara normalisht i merr përsipër sigurimi bazë. Pедиатрja, pediatri apo këshillimorja për prindër japin informacione për vaksinat.

Ndërprerja e shtatzënisë

Në Zvicër, ndërprerja e shtatzënisë lejohet në tre muajt e parë të shtatzënisë. Pas kalimit të javës së 12 të shtatzënisë, një abort është vetëm i mundur, nëse rrezikohet shëndeti fizik dhe/apo psikik i gruas. Këtë duhet ta vlerësojë një mjekë apo mjek. Kush mendon për një ndërprerje të shtatzënisë, ka të drejtë për një këshillim falas. Gra të reja nën 16 vjeç duhet t`i drejtohen një këshillimoreje e specializuar. Shpenzimet për të gjitha shërbimet mjekësore mbulohen prej sigurimit bazë.



Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/shtatzenesia--lindja

Shëndeti psikik

Në Zvicër nuk bëhet dallim në mes sëmundjeve psikike dhe fizike. Sigurimi bazë e paguan trajtimin e personave me sëmundje psikike tek specialistët si dhe shtrime në klinika.

Mbështetja dhe këshillimi

Për situata të vështira personale apo familjare ka shumë persona të specializuar në Zvicër, të cilët ndihmojnë më tej. Sigurimi bazë (Grundversicherung) e paguan trajtimin e sëmundjeve psikike te specialistët e certifikuar sipas ligjit siç janë psikiatret dhe psikiatrit. Qëndrimet në klinikë paguhen po ashtu. Kush ka probleme, mund t'u drejtohet këshillimoreve anonime falas. Kështu këshillon për shembull Dora e Zgjatur përmes telefonit, e-mailit apo me chat (telefon 143, www.143.ch). Mirëpo edhe mjekja apo mjeku familjar (Hausärztin oder Hausarzt) mund të ndihmojë. Kur një person është i rrezikuar në formë akute, që ai t'i bëjë diçka vetes apo tjetrit, duhet të vepohet shpejt. Në këto raste urgjente ndihmon policia (telefoni 117).

Fëmijët dhe të rinjtë

Për të rinjtë me probleme psikike, kontaktimi i shërbimit psikologjik shkollor (Schulpsychologischer Dienst) pa pagesë është një hap i parë i mirë. Edhe prindërit, të cilët brengosen për fëmijët e tyre, mund të lajmërohen aty. Mbështetje anonime falas për fëmijë dhe të rinj ofron numri emergjent për fëmijë përmes telefonit, e-mailit apo me chat (Tel.147, www.147.ch). Për urgjencat psikiatrike të fëmijëve dhe adoleshentëve, prindërit mund të kontaktojnë klinikën psikiatrike për fëmijë dhe adoleshentë (Kinder- und Jugendpsychiatrie) në numrin 061 325 51 00.

Sëmundja e varësisë

Organizatat Ndhma ndaj varësive në rajonin Basel (Suchthilfe Region Basel) dhe Këshillimorja multikulturore për varësitë e të dyja Bazeleve (Multikulturelle Suchtberatungsstelle, MUSUB) ndihmojnë në raste të sëmundjeve me varësitë. Këto vende ofrojnë mbështetje dhe këshillim në mënyrë konfidenciale dhe falas. Edhe kur dikush brengoset për të afërmit ose për personat që ka pranë, mund t'i kontaktojë qendrat këshilluese. Këto ofrojnë këshillime edhe në disa gjuhë të huaja. Në sëmundjet e varësive nuk përfshihen vetëm varësia nga alkooli apo droga. Edhe te varësi të tjera si varësia nga loja, blerja apo interneti edhe te çrregullimet në të ngrënit, këshillimoret për varësitë ndihmojnë. Pyetjet mund të bëhen edhe përmes e-mailit.

Traumatizimi

Kush ka përjetuar në jetën e vet gjëra të këqija dhe nuk mund t`i përballojë, duhet të marr mbështetje. Sepse traumatizimet janë sëmundje, që duhet të merren seriozisht. Përveç ofertave të këshillimit dhe të mbështetjes për probleme psikike dhe sëmundje ka edhe zyra të specializuar dhe trajtime për viktime të luftës dhe torturës.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/shendeti-psiqik

Rasti i vdekjes

Kur një person prej familjes suaj vdes, ju duhet ta raportoni rastin autoritetit zyrtar. Nëse dëshironi, autoriteti thirr një shërbim funerali. Shërbimi funeral e transporton kufomën deri tek varrezat ose jashtë shtetit.

Raportimi i një vdekjeje

Kur një njeri prej familjes suaj vdes, një mjek ose mjeke duhet të plotësojë certifikatën e vdekjes. Pastaj ju duhet t'ia lajmëroni vdekjen zyrës së gjendjes civile të kantonit Basel-Stadt.

Personi vdes në spital, në strehimore pleqsh ose në stehimorën e përkujdesjes:

- Drejtorja e spitalit ose të strehimores duhet t'ia lajmërojë vdekjen zyrës së gjendjes civile.

Personi vdes në një vend tjetër:

- Ju si të afërmit duhet t'ia lajmëroni vdekjen zyrës së gjendjes civile të kantonit Basel-Stadt.

Çdo njeri, që jeton në kantonin Basel-Stadt, merr një varrim me arkivol ose me urnë falas.

Riatdhesimi i eshtrave

Ndoshta një person prej familjes suaj ka vdekur në kantonin Basel-Stadt. Por ju dëshironi, që personi të varroset jashtë shtetit. Për këtë, një kompani e licencuar funerali duhet të përpilojë një protokoll: Protokollit quhet "Protokoll për vendosjen në arkivol dhe për vulosjen". Origjinalin e protokollit duhet të parashtroni tek zyra e varrimeve të kantonit Basel-Stadt. Në vijim zyra e varrimeve lëshon një pasaportë kufome. Kompania e funeralit lejohet vetëm me këto dokumente ta transportojë kufomën drejt varrezave jashtë shtetit. Ju si të afërmit duhet t'i paguani shpenzimet për këtë shërbim.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendeti/todesfall